



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA DIVJAKE

Nr. 2337/prot.

Divjake me 15/09 2015

E lidhur sot ne daten 15.09.2015 midis paleve :

AUTORITETI KONTRAKTOR

Bashkia Divjake, lagja nr. 2 Divjake, perfaqesuar nga Kryetari i saj Z.Fredi Kokoneshi, i quajtur me poshte porositesi .

KONTRAKTUESI

Subjekti : Shoqeria " ERMIS KEST " , perfaqesuar nga Drejtuesi i saj Ligjor z. Kostaq Minxuri i quajtur me poshte "Mbikqyresi";

BAZA LIGJORE

1. Kontrata do te qeveriset dhe interpretohet sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise.
2. Kontrata hartohet ne baze te dispozitave ligjore te parashikuara nga nenet 659 dhe ne vazhdim te Kodit Civil, ligjit 9643 date 20.11.2006 " Per prokurimin publik "i ndryshuar dhe VKM Nr 914 date 29.12.2014 « Per miratimin e rregullave te prokurimit publik "i ndryshuar.
3. Dokumentacioni i tenderit eshte pjese perberese e kesaj kontrate.

OBJEKTI I KONTRATES

1. Objekti i kontrates eshte "Mbikqyrje punimesh me objekt : Ndertimi I Qendres Shendetesore Divjake "

CMIMI I KONTRATES:

Vlera totale e kontrates eshte: 90 (nentedhjete mije) leke pa TVSH .

AFATI

Afati eshte nga data 15.9.2015 - 7.12.2015 nga data e lidhjes se kontrates , afat i cili eshte i njejte me afatin e zbatimit te punimeve per kete objekt.

Pavaresisht sa me siper afati i kesaj kontrate do te shtrihet paralelisht me afatin e kontrates se lidhur ndermjet Autoritetit Kontrator dhe Kontraktorit per zbatimin e objektit duke perfshire dhe shtyrjet e mundeshme te afatit qe mund te lindin gjate zbatimit te kontrates.



NEGOCIATAT DHE AMENDAMENTET

1. Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
2. Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.
3. Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

DETYRIMET E MBIKQYRESIT


1. Mbikqyresi gjate gjithë veprimtarise duhet te zbatoje te gjitha dispozitat e parashikuara ne kete kontrate si dhe kerkesat e detyrimet qe rrjedhin nga Ligji Nr 8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" ,i ndryshuar, Udhezimi Nr.3 KM date 15.02.2001 per "Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve te Ndertimit", i ndryshuar .
2. Ne rast se Mbikqyresi deshton te kryeje sherbimet sipas percaktimeve te mesiperme porositesi ruan te drejten e nderprerjes te kontrates ne perputhje me nenin "NDERPRERJA PER MOSPLOTESIM " te kesaj kontrates.

AFATET E PAGESËS

1. Pagesa do te kryhet kur Porositesi ka marre faturen nga Mbikqyresi.
 2. Pagesat do te kryhen ne llogarine e Mbikqyresit, **ne Raiffesisen Bank,me IBAN**
-
3. Palet do te konsiderojne si dite te kryerjes se pageses, ditën kur llogaria e Porositesit do te preket per te bere kalimin e vlefte ne llogarine e Mbikqyresit.
 4. Monedha ne te cilen do te kryhet pagesa e Mbikqyresit do te jete me urdher xhirimi ne lek.
 - 5 Mbikëqyrësi i punimeve do te jete perballe investitorit teresisht teknikisht, administrativisht dhe juridikisht pergjegjes per mbikqyrjen e punimeve te realizuara sipas kesaj Kontrate. Pagesa e mbikqyresit do te behet ne masen 90% pas aktit te kolaudimit dhe ne masen 10% mbas marrjen ne dorezim te objektit.

VONESA NË ZBATIM DHE ZGJATJA E AFATIT

1. Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
2. Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.
3. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.



4. Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.

5. Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

6. Afati i kësaj kontrate do të shtrihet paralelisht me afatin e kontrates së lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit për zbatimin e objektit duke përfshirë dhe shtyrjet e mundshme të afatit që mund të lindin gjatë zbatimit të kontrates

LIKUIDIMI I DËMEVE PËR DORËZIMIN E VONUAR

Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:

4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

PRONA INTELEKTUALE

1. Të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

2. Mbikqyesi pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.


3. Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.

4. Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

NDRYSHIMI I LIGJEVE DHE RREGULLOREVE

Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullorë, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

FORCA MADHORE



1. Sigurimi i kontrates ne shumen prej 10% te vlefes se kontrates do te ofrohet nga Kontraktuesi per te siguruar ekzekutimin e detyrimeve te tij sipas kontrates.

2. Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

3. Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

TERHEQJA NGA KONTRATA

1. Seicila pale mund te terhiqet nga kontrata.
2. Kur Mbikqyresi terhiqet nga kontrata ai do te shlyeje detyrimet qe kane lindur nga realizimi i pjesshem i kontrates.
3. Porositesi mund te terhiqet nga kontrata ne rastin kur Mbikqyresi shkel ndonje dispozite te kontrates ose kur arrihet ne konkluzionin se Mbikqyresi nuk do te permbushe ne rregull detyrimet kontraktore.
4. Nese Porositesi terhiqet nga kontrata Mbikqyresi do te kerkoje demshperblim vetem per pjesen e realizuar te kontrates.

LAJMËRIMET

1. Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.
2. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

1. Porositesi dhe Mbikqyresi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.
2. Ne rast se palet nuk bien dakort atehere per sqarimin e mosmarrveshjes me mirkuptim atehere palet do t'i drejtohen Gjykates se Shkalles se Pare te Rrethit Lushnje .

Kjo kontrate quhet e vlefshme vetem pasi te jete nenshkruar nga te dyja palet.

Kjo kontrate u hartua ne 4 (kater) kopje, nga te cilat nje per Dosjen e Prokurimit, nje per Drejtorine e Finances, nje per veprimet me Thesarin dhe tjetra per Mbikqyresin.

KONTRAKTUESI

Shoqeria Ermist Kest

**Drejtues Ligjor
Kostaq Minxuri**



AUTORITETI KONTRAKTOR

BASHKIA DIVJAKE

**KRYETARI
Fredri KOKONESHI**

